

STATUTI I SHOQERISE

TREJTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “DITeMIR” SH.P.K

KREU I DISPOZITA TE PERGJITHSHME NENI 1

Sot me date 28.11.2024 në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare” i ndryshuar, me vullnet të lirë Ortaku i vetem i Shoqerise “DITeMIR” sh.p.k:

- DITMIR BERISHA**, biri i Sulejman, lindur ne Dege, Tropoje, i datelindjes 17.02.1987, shtetas shqipetar, banues ne Tirane, identifikuar në bazë të dokumentit Leternjoftim Nr. I70217009R madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

si themelues i Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar, vendos te hartoje këtë Statut, mbështetur në parimet e mëposhtme:

KREU II EMRI, FORMA, SELIA, KOHEZGJATJA NENI 2 EMRI

Emri i shoqërisë është “DITeMIR” shpk.

NENI 3 FORMA

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortaket do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara për kapitalin.

NENI 4 SELIA

Shoqëria e ka seline e saj në adresen: Rruga “ Themistokli Germanji” Nr 2, Perballe ish universitetit Luarasi, Njesia Bashkiake Nr 2,Tirane, Shqiperi

Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 5 KOHEZGJATJA

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.

KREU III NENI 6 OBJEKTI

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj, duke perfshire por pa u kufizuar ne:

- Tregtimin dhe import-eksportin me shumice e pakice, te te gjithe mallrave te gatshme dhe gjysem te gatshme me ose pa akcize, tregtimin me pakice te naftes, gazit natyror dhe nenprodukteve te tyre; tregetimin me pakice dhe ose me shumice te karburanteve.
- Ndertimin, rikonstrukcionin, shitjen, blerjen, administrimin, menaxhimin e drejtepredrejte si dhe marrjen dhe dhenien me qira te aseteve te palevizshme dhe te levizshme te cdo natyre brenda dhe jashte territorit shqipetar, implemetimi i projekteve te hoteleve.
- Ushtrimin e aktiviteve si Qiradhenie, Bar – Restorante, Parkim, Poligon i hapur dhe i mbyllur, Qender Fitnessi (Palester), sherbime pastrimi (perfshire dhe lavazh automjete).
- Sherbime te marketingut, promovimit dhe reklamimit per aktivitetet e veta dhe per palet e treta, sherbime te shitjes me pakice, sherbime administrim biznesi, reklame, funksione zyre, sherbime informacion biznesi, asistence menaxhimi, kerkime tregu, promovim shitjesh, rekrutim personeli, dhenie me qera te hapesirave reklamuuese.
- Sherbime IT, prodhim, shitje, asistenca e software dhe rrjeteve informatike, perpunimi i te dhenave dhe humlumtimi i tregut per kompanite e grupit si dhe per palet e treta te interesuara.
- Qender Trajnimi Privat per Sigurine Fizike, Trajnime deshmi aftesie sherbimi per here te pare, trajnime per njojjen dhe perdomin e armeve te zjarrit per shtetasit, trajnime per truproje fizike, trajnime per Operator te QMSH, trajnime per grupet e gatshme, trajnime baze.
- Sigurimi i objekteve Publike dhe Private, ne pronesi te personave Fizike dhe Juridike qe ushtrojne veprintari ne Republiken e Shqiperise.
- shoqëria mund të kryejë çdo veprim, operacion apo transaksion të ligjshëm tregtar e finanziar, duke përfshirë por pa u kufizuar në të drejtën e saj për të investuar, në instrumente finanziarë, tituj pjesëmarrje në kapitale, tituj borxhi, aksione e kuota dhe/ose fonde investimesh.
- Shoqëria do të ofrojë asistencë dhe konsulencë teknike, ligjore, financiare, administrative dhe shërbime të tjera të ligjshme të çdo lloji (pa kufizim) kundrejt shoqërive të tjera të zotëruara në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga ajo vetë apo ortakët e saj (shoqëritë e grupit).
- Të ofrojë këshillim finanziar duke përfshirë por pa u kufizuar në analizën financiare për strategjitet e zhvillimit, përgatitjen e planeve të biznesit / financimit, këshillim dhe asistencë në operacionet e investimeve, studim dhe kërkim burimesh financiare me kushte lehtësuese si dhe asistencë në operacionet e investimeve të paluajtshme.
- Të japë garanci të të gjitha llojeve në favor të shoqërive të grupit dhe të ofrojë shërbime të analizës, koordinimit, studimeve të tregut, etj

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njeqind mijë) Leke.

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara dhe nënshkruar si më poshtë:

1. **DITMIR BERISHA** në cilësinë e ortakut te vetem themelues zotëron 100% të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabartë me vlerën 100.000 Leke në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar i shoqerise do te shlyhet teresish brenda 2 (dy) muaj nga themelimi i shoqerise per kontributin ne para, qe do te depozitohet ne nje llogari bankare te hapur ne emer te Shoqerise ne nje nga bankat e nivelit te dyte.

Kapitali i shoqerisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjeherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumn ligjor.

NENI 8 **MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi t'ua kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë me kushte të njëjta nga ato që do j'u ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë të cilën duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit, në të kundërt oferta konsiderohet e refuzuar prej ortakëve që gjëzojnë këtë të drejtë.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit në QKB.

Kuotat janë të papjestueshme.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

KREU IV **ORGANET E SHOQËRISË** **NENI 9**

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme;
- Administratori.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME NENI 10 KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të mëposhtëme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të këtij nenit;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

NENI 11 MBLEDHJA E ASAMBLESË

Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimor. Ajo mblidhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" i ndryshuar. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët ose ortakët. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

NENI 12 THIRJA DHE VENDIMARRJA NË ASAMBLE

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Në rastin e marries së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërcjnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet

të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur më sipër, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 10 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

NENI 13 ORGANI ADMINISTRATIV

Administrator i parë i shoqërisë per një periudhe 5 (pese) vjecare duke nisur nga data 28.11.2024 deri ne 27.11.2029 , eshte emeruar **Z. DITMIR BERISHA**, shtetas shqipetar, pajisur me pasaporte me nr. I70217009R.

NENI 14 KOMPETENCAT

Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (pese) vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Administratori ka këto kompetenca:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c) të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) të raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Administratori është kompetent edhe për të:

- realizuar mbledhjen e asamblesë duke rjoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
- propozuar strukturen e aparatit te shoqërisë;
- marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

**KREU V
NENI 15
PRISHJA E SHOQËRISË**

Shoqëria prishet:

- a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është rjoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKB;
- ç) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare.

Me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likuidimit. Gjate fazes se likuidimit emrit te shoqerise i shtohet pjesa "Ne likudim" qe shenohet ne te gjitha dokumentet qe shoqeria nxjerr gjate kesaj perjudhe.

Likujduesi i emruar nga Asambleja e Pergjitheshme, kerkon çregjistrimin e shoqerise pranë QKB, pas shperndarjes se aktiveve te mbeturat te shoqerise.

**NENI 16
BILANCET**

Ne perputhje me ligjin, shoqeria do te kete një regjister ne te cilin mbahen bilancet vjetore, raporte financiare vjetore dhe cdo kerkese tjeter ligjore.

**NENI 17
VITI FINANCIAR**

Viti finanziar i shoqerise fillon ne 1 janar te cdo viti kalendatik dhe perfundon ne 31 dhjetor te po ketij viti me perjashtim te vitit te regjistrimit ku viti finanziar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise dhe perfundon ne 31 dhjetor.

NENI 18 DIVIDENTËT

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe shperndarjes se te ardhurave, Asambleja percakton shumen qe do te ndahet si dividente, bazuar ne kuotat qe zoteron çdo ortak.

NENI 19 PARASHIKIME PERFUNDIMTARE

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe aktit të themelimit dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqeria ka vulen e vet ne te cilen shkruhet emri i shoqerise, numri i regjistrimit te subjektit.

Per ato qe nuk jane parashikuar ne kete statut zbatohen dispozitat e ligjit per shoqerite tregtare. Statuti eshte hartuar ne 2 (dy) kopje ne gjuhen shqipe, duke patur secila kopje fuqi te njejte ligjore.

**THEMELUESI
Z. DITMIR BERISHA**

